



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 137 Prot

Tiranë, 10 /03/2020

URDHËR

Nr. 157 Datë 10 /03 /2020

-PËR

**MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E INFEKTIMIT NGA COVID-2019 TË PËRFITUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

Mbështetur në nenin 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin nr. 10107 datë 30.03.2009, i ndryshuar "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 08.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Në institucionet e përkujdesit shoqëror pezullohen/ndalohen vizitat nga të afërm dhe familjarë. Në raste specifike vizitat mund të lejohen vetëm me miratim e titullarit të Shërbimit Social Shtetëror.
2. Institucionet e përkujdesit shoqëror të marrin masa të shtuara higjiëno-sanitare, deri në dezinfektimin e ambientit nëse kjo do të rekomandohet nga strukturat përgjegjëse.
3. Të gjitha njësitë vendore të kujdesit shëndetësor të vendosin kontakte me drejtuesit/mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror, rezidenciale dhe ditore, publike dhe jopublike dhe të monitorojnë situatën shëndetësore të përfituesve që marrin shërbim pranë këtyre institucioneve dhe personelit të institucionit.
4. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror rezidencial dhe ditore, publike dhe jopublike, të raportojnë në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor dhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror mbi monitorimin e procesit në këto institucione.

5. Mjekët që ushtrojnë veprimtari pranë institucioneve të përkujdesit shoqëror rezidencial dhe ditor, publike dhe jopublike, për çdo rast të dyshuar ndjekin Protokollin e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor, të cilët duhet të bashkërendojnë punën me njësitë e vetqeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

